



Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe paragrafit 6, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 nën paragrafi 2.3 dhe paragrafit 3 dhe 4 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024, me datë 04.09.2024 publikon këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

1. Kandidatët për ekspertë të jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me dispozitat e nën paragrafit 2.3 paragrafi 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë
- vendit, nevojitet nostrifikimi;
- të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të
- nivelit drejtues;
- të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5)
- vitet e fundit;
- të kenë integritet moral dhe profesional;
- të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e
- masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

2. Për Kandidatët për ekspert i jashtëm të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar
- nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për ekspertë të jashtëm për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikët 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga data 05/09/2024 deri më datë 12/09/2024 deri në ora 16:00.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për *ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese* dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: fmulaj@kosovo-mining.org;

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 240 252 -203 ose në email adresen: fmulaj@kosovo-mining.org

Ju faleminderit!